

**Njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë të vetëm
nga KORPORATA KSORANT, SHBA ndaj Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
TestDevLab, Letoni
(lënda nr. 08-136 /2025)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18, 208/24 dhe 16/25), më datë 17.09.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim, me të cilin KORPORATA KSORANT me seli në Avenija Rimvud Sanivejl, Kalifornia 94089, SHBA, veprimtaria kryesore e së cilës është zhvillimi i produkteve softuerike, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, Andrejs Frisfelds dhe Ervins Grinfelds, kanë nënshkruar një Letër Qëllimi në lidhje me shitjen e të gjitha pjesëve në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar TESTDEVLAB, një shoqëri e themeluar në pajtim me ligjet e Letonisë, me seli në adresën Rruga Vingrotaju 1, Rigë, LV1010, Letoni, veprimtaria kryesore e së cilës është ofrimi i shërbimeve të tjera të teknologjisë informatike dhe kompjuterike.

-KORPORATA KSORANT është një shoqëri, veprimtaria kryesore e së cilës është zhvillimi i produkteve softuerike. KORPORATA KSORANT nuk është e pranishme në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka realizuar qarkullim në Maqedoninë e Veriut.

-Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar TestDevLab është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes personit të saj juridik të lidhur - **TESTDEVLAB SHPKNJP Shkup**, me seli në bul. "8 Shtatori" nr. 16, kati 2, Qendra e Biznesit Hyperium, Shkup-Karposh, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, me veprimtari prioritare - kryerja e veprimtarive të tjera lidhur me teknologjinë informatike dhe kompjuterët. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar TESTDEVLAB realizon qarkullim në Maqedoninë e Veriut.

Transaksioni i referohet fitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë dhe të vetëm mbi Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar TESTDEVLAB nga ana e KORPORATËS KSORANT. Kjo do të realizohet përmes blerjes së të gjitha pjesëve në Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar TESTDEVLAB nga Korporata Ksorient, të cilat aktualisht janë në pronësi të Andrejs Frisfelds dhe Ervins Grinfelds, nga ana e korporatës Ksorient, në përputhje me nenin 12, paragrafi 1, pika 2 të Ligjit.

Në bazë të hetimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni u bën thirrje palëve të treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre për këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe ato duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

18.09.2025

Shkup